



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE, PRONAVE DHE TRANSPORTIT

RELACION

MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN "PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA".

Të nderuar Këshilltare !

Bashkia Berat e ka prioritet të saj strehimin e familjeve në nevojë të pa favorizuara e me probleme sociale .

Për ti ardhur ne ndihmë kësaj shtrese edhe per këtë vit bashkia ju ka sjellë për miratim disa vendime për ti zvogeluar sado pak problemet e tyre financiare në lidhje me strehimin si:

- Me VKB nr.19, datë 29.03.2021 është miratuar lista e familjeve të pastreha të përbërë nga 33 familje që përfituan bonus qiraje në tregun e lire me vlerën 3,366,080 lekë ku gjysmën e fondit do ta mbulojë bashkia dhe gjysëm qeveria.
- Me VKB nr.20, datë 29.03.2021 është miratuar lista e familjeve të strehuara në banesat sociale që përfituan subvenconim të qirase .Ku perfitues kanë qënë 31 familje me shumen një shumë prej 1,709,900lekë.

Bashkia Berat ju përgjigj pozitivisht edhe për këtë vit kërkesës së Ministrisë së Financave "Për projektet e investimit që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2021", duke aplikuar për projektin " Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", pasi kemi nje numër të konsiderueshëm rreth 39 familje te identifikuar nga ana jonë , që jetojne në banesa të amortizuara dhe jashtë kushteve teknike .

Theksojme se gjate vitit 2020 u trajtuan me këtë projekt 14 familje me nje vlere 11,930,766 ku bashkia mbuloi 25 % te fondit .

Kushtet që duhet të plotësojë Bashkia për t'u kualifikuar është përqindja e bashkëfinancimit për projektin, të jetë jo më pak së 20 % e koston totale të projektit, ne ju propozojmë të miratoni financimin në masën 20 % të koston së projektit ..

Ne kemi përgjedhur 39 familje dhe 5 banesa kolektive (investime ne çati dhe fasadë) me kosto totale 70,136,167 lekë, që do të trajtohen me këtë projekt të cilët plotësonin dokumentacionin e pronësisë ,pasi pjesa tjetër kishin probleme me këto dokumenta.

Drejtore i E.P.T
Erlin Kuçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

MBI MIRATIMIN E DEKLARATËS PËR BASHKËFINANCIMIN E BASHKISË NË PROJEKTIN "PËRMIRËSIM I BANESAVE EKZISTUESE PËR KOMUNITETET E VARFËRA DHE TË PA FAVORIZUARA".

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, neni 9, pika 1.1 , neni 24, neni 54, neni 64 gërma "c"; pika 34,45 e nenit 2, neni 33, 34 të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", VKM nr. 454, datë 3.7.2019 " Për procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese" , VKM nr. 458, datë 3.7.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak;

VENDOSI:

1.Të miratoj , deklaratën për bashkëfinancimin e bashkisë Berat në projektin " Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara", në masën 20 % të kostos totale të projektit.

2. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e Drejtoria e Menaxhimit Financiare dhe e të Ardhurave , Drejtoria e Emergjencave Civile, Pronave dhe Transportit.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ervin Ceca